

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Grabitet shtëpia e Kardinalit Ernest Simoni në Firence, hajdutët marrin sende me vlerë dhe 30 mijë euro
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/grabitet-shtepia-e-kardinalit-ernest-simoni-ne-firence-hajdutet-marri-i474565
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 15:59:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7c6a2a9a78e1140f2f12ec454f12d01687e987386956b875aac3614b64b548ab
TEKSTI	287d0375e8e65082743334c20fd86f7e3a81fc919785ca36194bac8b81683652
PAMJA	4fbaad26354649efd056ef422304bdcb972d62484a732a20aafcd0dafeccf8c4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9f5f138323323a64b40beec8457a65ebce56d3f9a6f30e87de52439091b23f73
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9f5f138323323a64b40beec8457a65ebce56d3f9a6f30e87de52439091b23f73>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

17:16 Aktualitet

Biznesmeni Behgjet Pacolli ka reaguar sërish në lidhje me ...

Grabitet shtëpia e Kardinalit Ernest Simoni në Firence, hajdutët marrin sende me vlerë dhe 30 mijë euro



18 Shtator 2026, 17:50, Aktualitet CNA



Një grabitje e pazakontë ka ndodhur në zonën e Piazza Duomo në Firence, ku ndodhet apartamenti ku jeton kardinali shqiptar Ernest Simoni, 97 vjeç, së bashku me nipin e tij. Hajdutët kanë arritur të hyjnë në banesë pasi kanë thyer murin dhe kanë hapur derën e blinduar, duke marrë sende me vlerë rreth 30 mijë euro.

Sipas [Corriere Fiorentino](#) ngjarja është zbuluar të martën në mërkurë, rreth orës 23:00, kur nipi i kardinalit, Tonin Simoni u kthye në shtëpi.

Hajdutët kishin përdorur mjete të posaçme për të çarë murin dhe për të depërtuar në apartament. Dy dalta të përdorura gjatë grabitjes u gjetën të braktisura në korridor. Brenda banesës, dollapët, kutitë dhe valixhet ishin hapur dhe gjithçka ishte lënë në rrëmujë.

"Jemi të tronditur nga ajo që ndodhi. Ndihehim të sigurt dhe nuk do ta kishim menduar kurrë se hajdutët do të arrinin të bënë një gjë të tillë pikërisht në Piazza Duomo. Është një turp për qytetin", tha Tonin Simoni.

Mes sendeve të grabitura janë para të gatshme, sende ari, bizhuteri, disa medalje, një vulë ari dhe sende të tjera personale. Hajdutët kanë marrë gjithashtu një kablo të vjetër PlayStation, që u përkiste fëmijëve të familjes, si dhe lejen e qëndrimit të kardinalit Ernest Simoni.

Ky i fundit nuk ndodhej në Firence në momentin e grabitjes. Kardinali shqiptar ndodhet aktualisht në Londër, ku ka pasur një takim me Mbretin Charles.

"Humbja e lejes së qëndrimit është mjaft e çuditshme. Përveç nëse dikush ka pasur qëllim ta falsifikojë atë", u shpreh nipi i kardinalit.

Karabinierët mbërritën menjëherë në vendngjarje, ndërsa ekspertët kriminalistikë po kryejnë hetime për mbledhjen e gjurmëve dhe provave që mund të çojnë te autorët. Hetuesit po shqyrtojnë gjithashtu pamjet e kamerave të sigurisë në Piazza Duomo.

Sipas Tonin Simonit, fakti që grabitësit arritën të vepronin në një nga zonat më të ruajtura të Firences ngre dyshime se banesa mund të ketë qenë nën vëzhgim.


"Duhet të kenë ditur që nuk ishim në shtëpi. Nuk mendoj se ishte një rastësi", tha ai.

Pas ngjarjes, familja kaloi natën duke rregulluar dëmet dhe duke qëndruar në banesë, pasi dera e sigurisë nuk mund të mbyllej.

Kur nipi e telefonoi kardinalin në Londër për t'i treguar për grabitjen, shqetësimi i parë i Ernest Simonit nuk ishin sendet e vjedhura, por statujat fetare që mbahen në dhomën e tij, e cila i ngjan një faltoreje.

"A i lanë statujën e Zonjës së Medjugorjes? Po statujën e Padre Pios?", pyeti kardinali, sipas nipit të tij.

Pasi u sigurua se statujat ishin të gjitha në vend, Ernest Simoni u përgjigj: "Atëherë nuk ka problem." / CNA





Të sugjeruara

Aeroporti i Vlorës/ Pacolli: Çështja po kalon në duart e drejtësisë ndërkombëtare

Paralajmërimi i Ramës për furnitorët dhe supermarketet/ Bozdo: Kur s'ke çfarë t'i bësh gomarit, i bie samarit

Akuzat e Ahmetajt për trafik armësh/ Mediu: Duhet të kryhet hetim

Kuvendi miratoi projektligjin për pagat e magistratëve/ Unioni i Gjyqtarëve: Do të shkojmë në Kushtetuese

BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por ujë 24 orë nuk ka

Gjykata lë në burg kushëririn e Agasit, dosja i kalon SPAK-ut

Zjarr në malin e Moravës

"Agro Invest Korça" pjesë e "Serenights Festival"/ Spiro Fuqi për CNA: Viojmë traditën e kulinarisë korçare

Ngërçi me pagat e magistratëve/ SPAK merr në pyetje drejtoreshën e Thesarit

"Erion Veliaj, piramidë krimi elektorale"/ Berisha: Ka një luftë të madhe mes tij dhe Ramës

"Qëndron pas aferës 130 milionë euro"/ Berisha: Nëse ka një njeri që prish provat është Erion Veliaj

Berisha për Zvernecin: Është dhënë leje ndërtimi pa respektuar ligjin

Heqja e non gratës/ Berisha: Zgjidha gjykatën për të mbrojtur dinjitetin tim

110 ditë protestë/ Qytetarët përpara Komisaritit 1

Berisha: Ia ofroi dorëheqjen ish-kryeministrit të UCK-së

[Berisha: Ja çfarë do të bëjë ish-kryetari i UÇK-së](#)

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Berisha zbulon kërkesën që i bëri Hillary Clinton](#)

[Ngritja e gjykatës speciale të Kosovës/ Berisha: Rama fluturoi me helikopter për të përcaktuar votimin](#)

[Dita e 110 e protestës/ Qytetarja: Para Parlamentit dhunë si ajo e Zvërnecit](#)

[Pagat e magjistratëve/ SPAK nis hetimet, sekuestrohen praktikat te Ministria e Financave](#)


[Interpelanca për bypassin e Elbasanit/ Karakaçi: Kosto 240 mln euro, në fokus reduktimi i trafikut](#)

[editorial](#)

14:57 Editorial CNA

[Kafka i gjorë dhe avokatët që e kanë kthyer Erion Veliajn në biznes](#)

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

[Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH](#)

[opinion](#)

17:02 Opinione Belind Këlliçi

Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!

09:14 Opinione Besim Ndrejoni

Bojkotoni takimet me politikanët e Shqipërisë që mbajnë peng demokracinë!

13:25 Opinione Lutfi Dervishi

Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë

[Lifestyle](#)